



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 243, Datë 23.09.2022

MBI

**KËRKESËN E OST SH.A., PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2023 DHE PERIUdhËN 2023-2025**

Në mbështetje të neneve 16, 19, gërma “c”, pika “i”, nenit 21 dhe nenit 55 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.06.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; nenit 15 dhe nenit 19, pika 1 gërma “c” dhe pika 3 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 17.06.2016; “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.180, datë 08.11.2017, si dhe vendimit të bordit të ERE-s nr. 244, datë 26.11.2018 “Për miratimin e sistemit të njehësuar dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike”; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.09.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1522/1 prot., datë 21.09.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi kërkesën për aplikim për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2023 dhe periudhën 2023-2025”,

Konstatoi se:

- Shoqëria Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) me shkresën nr. 5303 prot., datë 31.08.2022 (protokolluar me tonën me nr. 1522 prot., datë 06.09.2022), ka paraqitur në ERE kërkesën për aplikim për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2023 si dhe për periudhën 2023-2025, e cila është në përputhje me afatet e parashikuara në pikën 1 të nenit 21 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016.
- ERE me anë të vendimit të bordit nr.72, datë 13.04.2022 ka miratuar tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike prej 0.85 lekë/kWh, për periudhën rregullatore 1 Maj 2022 – 31 Dhjetor 2024.

- Shoqëria OST sh.a., ka paraqitur për miratim në ERE tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2023 si dhe për periudhën 2023-2025, në shumën prej 2.18 lekë/kWh.
- Aplikimi i shoqërisë OST sh.a., i paraqitur në ERE për miratim, i referohet një periudhe të rregullatore 3 vjeçare (2023-2025), e ndryshme nga ajo e kërkuar nga shoqëria dhe e miratuar nga ERE me vendimin e sipërcituar, e cila nuk mbështetet në parashikimet e Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit, për sa i përket parimeve rregullatore dhe qëndrueshmërisë së tarifave në kohë.
- Në këtë aplikim konstatohet se OST sh.a., ka rishikuar të gjitha kostot apo komponentët e të ardhurave të kërkuara në rritje, nga ato të vlerësuara dhe miratuara nga ERE me vendimin e bordit nr.72, datë 13.04.2022. Ndryshe nga sa parashikohet në Metodologjinë sipërcituar, OST sh.a., nuk ka paraqitur elementët e korigjueshëm/axhustueshëm të tarifës mesatare tavan apo të ardhurave të kërkuara, të cilat në zbatim të pikës 7, të nenit 11 të saj, parashikon që kryhet axhustim/korigjim në tarifën mesatare tavan në vitin e ardhshëm, pavarësisht se axhustimet bëhen në periudhën rregullatorë pasardhëse.
- Me VKM nr. 456/2022, kosto e blerjes së energjisë për humbjet do të mbulohet nga shoqëria KESH sh.a., përgjatë gjithë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesis ekzisutes me përparësi, çmim i cili ka vlerën tavan prej 8.5652 lekë/kWh.
- Masat e marra nga qeveria shqiptare lidhur me gjendjen e emergjencës për furnizim, të cilat janë parashikuar në dispozitat e VKM nr. 456/2022, lidhur me prokurimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a., si dhe të ardhurat e tjera të realizuara gjatë kësaj periudhe, i mundësojnë shoqërisë të përballojë këtë shpenzim, duke mos ndikuar në tarifën mesatare të transmetimit të miratuar, me vendimin nr. 72/2022 të bordit të ERE.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 230, datë 12.09.2022 ka miratuar kontratën e shit-blerjes së energjisë elektrike midis shoqërisë publike të prodhimit, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik “KESH sh.a.” dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit “OST sh.a.” për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit për periudhën kohore 02.07.2022 deri në datën 31.12.2022.
- Ndër të tjera, Metodologjia parashikon në pikën 10, të nenit 11 se në rast të një ngjarje të “forcës madhore” që çrregullon sistemin e transmetimit, OST sh.a., mund t’i paraqesë në çdo kohë ERE-s një kërkesë për leje për të axhustuar pagesën e energjisë në tarifën e transmetimit në mënyrë që OST sh.a., të arkëtojë një shumë specifike shtesë të ardhurash por duke synuar të arrijë tarifa transmetimi të qëndrueshme dhe të parashikueshme.
- Për aq kohë sa shoqëria nuk është përballur me një shpenzim të jashtëzakonshëm apo me një ngjarje të forcës madhore, atëherë në zbatim të parashikimeve të Metodologjisë, komponentët të cilët do të jenë të korigjueshëm në vitin e dytë të periudhës rregullatore (2023) janë ato të cilët lidhen me: koston e humbjeve, realizimin dhe kapitalizimin e investimeve si dhe sasinë e energjisë së lëvruar në rrjet, elementë të cilët mund të kenë pësuar ndryshime eksponenciale në vitin bazë të periudhës rregullatore (viti 2022) nga ato të parashikuar në vendimin për tarifën

e transmetimit për periudhën rregullatore 3 vjeçare 2022-2024.

- Metodologjia e llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nuk lejon korrigjimin e kostove të tjera operative dhe kapitale vit pas viti brenda periudhës rregullatore.
- Bordi i ERE-s në konstatimet e vendimit nr. 72/2022 është shprehur se OST sh.a., duhet të paraqesë planin e investimeve për periudhën rregullatore 2022-2024 dhe përditësimin e planit të zhvillimit të rrjetit të transmetimit për periudhën 10-vjeçare, 2015-2025, në zbatim të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 135, datë 06.09.2017 dhe përcaktimeve të pikës 3 të VKM-së nr. 584/2021.
- OST sh.a., nuk ka përcjellë në ERE për shqyrtim planin e investimeve për periudhën në të cilën shtrihet periudha rregullatore 2022-2024 si dhe përditësimin e “Planit 10 vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit (2015-2025)” të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 212, datë 28.12.2017. OST sh.a. me shkresën nr. 3788, datë 15.06.2022 përcolli në ERE, kërkesën për miratimin e planit të investimeve të vitit 2022, ndryshe nga sa lënë detyrë në vendimin e bordit të ERE nr. 72 datë 13.4.2022 të sipërcituar.
- Në kushtet kur shoqëria OST sh.a., nuk është përballur me shpenzime të jashtëzakonshme dhe ngjarje të forcës madhore për vitin 2022, kërkesa e shoqërisë për aplikimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2023 dhe periudhën rregullatore 2023-2025, vlerësohet si e paarsyetuar dhe e pa mbështetur në parashikimet e legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës për aplikimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2023 si dhe për periudhën 2023-2025, prej 2.18 lekë/kWh.
2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI